



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI-TURIZËM"
TIRANË**

Nr. 474 Prot

Tiranë, më 12.11.2024

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",
Shkolla e mesme profesionale "Hoteleri-Turizëm", Tiranë ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1 (një) Mësues i formimit Teori-Praktik drejtimi "Hoteleri –Turizëm" Lënde Ekonomike (kohë e pjesshme)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriterete përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

2. Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

3. Krite të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit praktik në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

- a) të ketë të paktën diplomë nivelit master profesional ose të barasvlerfshme, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit
- d) preferohet të ketë njohuri të gjuhës Angleze

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
 - a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në);
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
 - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
2. Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.
3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e institucionit, brenda datës 21.11.2024

